



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

PROGRAMI I STATISTIKAVE ZYRTARE

2018-2022

Prishtinë,
Dhjetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
1	VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM 6
1.1	Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare 8
2	SISTEMI STATISTIKOR I KOSOVËS 9
2.1	Parimet e Planifikimit 9
2.1.1	Ligji mbi Statistikat Zyrtare 9
2.1.2	Procesi planifikues..... 9
2.1.3	Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane 10
2.1.4	Rekomandimet nga “Peer Review” dhe Këshilli Statistikor 11
2.2	Përshkrimi i sistemit 11
2.2.1	Përdoruesit 11
2.2.2	Këshilli Statistikor..... 11
2.2.3	Korniza planifikuese strategjike 12
2.2.4	Prodhuesit 12
2.2.5	Burimet Financiare 15
2.2.6	Ofruesit..... 18
2.3	Korniza e Vlerësimit të Performancës 19
2.3.1	Hyrje..... 19
2.3.2	Përshkrimi i Sistemit të KVP-së..... 19
2.3.3	Treguesit e Performancës 20
2.3.4	Gjendja bazë dhe pikësynimet 22
3	VËSHTRIM MBI PRODHIMIN 25
3.1	Tabelat e prodhimit..... 26
4.1	Kërkesat e zhvillimit 33
4.1.1	Historiku 33
4.1.2	Rekomandimet nga vlerësimet aktuale 33
4.1.3	Zhvillimet Statistikore 35
4.1.4	Vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut..... 37
4.2	Objektivat..... 38
4.2.1	Objektivat institucionale..... 38
4.2.3	Matricat e objektivave strategjike..... 41
4.2.3	Matricat e objektivave sipas fushave statistikore 41
4.3	Prioritetet strategjike 52
	Anekset 1. Përshkrimi i Produktit dhe Procesit Statistikor 57
	Anekset 2. Pyetësi i Përdoruesve 58
	Anekset 3..... 59
	Aneksi 4. Referenca..... 60

SHKURTESAT

SBM	-	Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit
PVSZ	-	Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare
BP	-	Bilanci i Pagesave
BQK	-	Banka Qendrore e Kosovës
IKN	-	Indeksi i Kostos se Ndërtimit
AHSID	-	Anketa për Harmonizimin e Statistikave për Investimet Direkte
CPIS	-	Anketa për Harmonizimin e Statistikave për Sigurimin e Investimeve
KPA	-	Klasifikimi i produkteve sipas aktiviteteve
IÇK	-	Indeksi I Çmimeve te Konsumit
PDSZ	-	Programi i Domosdoshëm i Statistikave Zyrtare
DEMO	-	Statistikat e Demografisë
DSH	-	Departamenti i Shpërndarjes
DME	-	Departamenti i Makro ekonomisë
DSS	-	Departamenti i Statistikave Sociale
SMIA	-	Sistemi Menaxherial Informativ i Arsimit
PZSZ	-	Programi i Zgjeruar i Statistikave Zyrtare
ES	-	EUROSTAT
SELL	-	Sistemi European i Llogarive
SSE	-	Sistemi Statistikor European
FET	-	Fondacioni European per Trajnim
BE	-	Bashkimi European
FSQ	-	Situata Financiare
BPV	-	Bruto Produkti Vendor
GIS	-	Sistemi Informativ Gjeografik
ABEF	-	Anketa e Buxhetit te Ekonomive Familjare
FMN	-	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇI	-	Indeksi i Çmimit te Importit
IPA	-	Instrumenti i Para – Anëtarësimit
ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
AFP	-	Anketa e Fuqisë Punëtorë
MM	-	Memorandum Mirëkuptimi
KASH	-	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
LLK	-	Llogaritë Kombëtare
NACE	-	Nomenklatura e Aktiviteteve Ekonomike
OECD	-	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
ZK	-	Zyra e Kryeministrit
KVP	-	Korniza e Vlerësimit të Performancës
SPIN	-	Statistikat mbi Pozicionin e Investimeve Ndërkombëtare
POS	-	Programi i Statistikave Zyrtare
IÇP	-	Indeksi i Çmimit të Prodhimit

RBM	-	Rezultatet e Bazuara në Menaxhim
ASN	-	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
SCB	-	Statistikat e Suedisë
Sida	-	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SKNJ	-	Statistikat mbi Kushtet Ndërkombëtare të Jetesës
SLL	-	Sistemi i Llogarive Kombëtare
ATN	-	Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve
AT	-	Asistence Teknike
KB	-	Kombet e Bashkuara
PKBZH	-	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
FKBP	-	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsi
FKBPF	-	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
KBMIK	-	Kombet e Bashkuara Misioni në Kosovë
BB	-	Banka Botërore

HYRJE

Vizioni

Vizioni i Sistemit Statistikor të Kosovës (SSK) është që përmes vendosjes dhe zbatimit të standardeve moderne statistikore ta ngrisë edhe më shumë besueshmërinë dhe sigurinë e të dhënave statistikore. Kjo do të arrihet me avancimin e vazhdueshëm të metodologjisë, avancimin e proceseve prodhuese statistikore dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare në përputhje me kërkesat e përdoruesve.

Misioni

Misioni i SSK-së është që t'i përmbush kërkesat e përdoruesve pa dallim, me të dhëna statistikore në aspektin e sasisë, të cilësisë, të besueshmërisë dhe objektivitetit. Të dhënat do të vihen në dispozicion në kohën e duhur me qëllim të lehtësimit të përpjekjeve planifikuese dhe zhvillimore në nivel vendi, komune dhe vendbanimi.

Pra, SSK ka për mision t'ju ofrojë të gjithë përdoruesve, qofshin ata nga institucionet qeveritare, institucionet kërkimore apo akademike, komuniteti ndërkombëtar, komuniteti i biznesit, shoqëria civile dhe publiku i gjerë, informata cilësore statistikore. Ky sistem duhet t'i përmbushë kërkesat e Ligjit për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës në përputhje me standardet ndërkombëtare.

1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Programi i Statistikave Zyrtare (PSZ) përmban objektivat dhe prioritetet e Sistemit Statistikor të Kosovës dhe bazohet në Ligjin për Statistikat Zyrtare, Nr 04/L-036. Në pjesën e parë të Ligjit aktual dhe në draftin e plotësim-ndryshimit të Ligjit për Statistikat Zyrtare, që është në proces të miratimit, janë vendosur Parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, mbi të cilat mbështetet Sistemi Statistikor i Kosovës (SSK). Përmes të njëjtit ligj, respektivisht te pjesa e planifikimeve të programeve strategjike, janë të përcaktuara kriteret dhe standardet mbi të cilat ndërtohet Programi statistikor. Aty është e përcaktuar edhe periudha minimale, që duhet të respektohet, periudhë e bazuar në praktikën e programeve strategjike të Eurostatit e që është periudhë pesëvjeçare.

Sipas Ligjit, Statistika Zyrtare janë statistikat e prodhuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Banka Qendrore e Kosovës (BQK), Ministria e Financave dhe institucionet e tjera, të autorizuara nga ASK-ja, sipas kriterëve për Statistika Zyrtare që përcaktohen po ashtu nga ASK-ja.

Programi i Statistikave Zyrtare 2018-2022 është plani i dytë strategjik pesëvjeçar mbi zhvillimin e Sistemit Statistikor të Kosovës, që përfshin prioritetet dhe objektivat e kësaj periudhe. Programi bazohet në rezultate dhe problematikat e periudhës paraprake dhe është i orientuar në procese dhe i bazuar te nevojat e përdoruesve. Programi, gjithashtu përmban burimet aktuale dhe të planifikuara për periudhën e caktuar, të klasifikuara sipas llojit të burimeve. Një hapësirë shumë të rëndësishme të këtij dokumenti e ka Korniza e Vlerësimit të Performancës (KVP), me qëllim që procesit të planifikimit strategjik afatgjatë, t'i jep segmente performuese vjetore. Fazat e shumta monitoruese (në nivel ore, jave, muaji dhe viti) krijojnë performancën vjetore, ndërsa fazat e ndryshme monitoruese krijojnë mundësinë e rivlerësimit të prioritetëve strategjike. Kjo praktikë e realizuar deri tani, ka ndërtuar një cikël standard të planifikimit, që e kanë edhe shumë institute statistikore të vendeve të BE-së.

Është me rëndësi të theksohet se objektivi i përgjithshëm i këtij Programi është avancimi dhe zhvillimi në një nivel më të lartë të SSK-së në aspektin e qëndrueshmërisë dhe të besueshmërisë statistikore. Prandaj, me qëllim të përmbushjes së kërkesave dhe standardeve kombëtare e ndërkombëtare, Sistemi Statistikor i Kosovës do të vazhdojë të zhvillohet, duke rritur produktivitetin dhe cilësinë e statistikave zyrtare në vend.

Objektivi i përgjithshëm i këtij Programi përbëhet nga dy objektiva të veçanta: efikasiteti organizativ dhe produktiv; cilësia dhe dobishmëria e prodhimit statistikor.

Efikasiteti organizativ dhe produktiv

Pavarësisht se në periudhën e kaluar ka pasur rritje dhe avancim të kapaciteteve organizative të gjitha institucionet që prodhojnë statistika zyrtare, me objektivat e vendosura në Programin e ardhshëm pesëvjeçar, synohet që të ketë rritje në vazhdimësi të efikasitetit organizativ dhe produktiv. Gjithashtu, bashkë me konsolidimin institucional

synohet edhe rritja e kapaciteteve profesionale dhe e burimeve të tjera, që përcaktojnë si tërësi efikasitetin organizativ, që synohet të avancohet në periudhën e ardhshme pesëvjeçare. Vënia në funksion i të gjitha kapaciteteve dhe burimeve të theksuara më lartë do të rritet domosdoshmërisht edhe produktivitetin.

Prandaj, objektivat kryesore për ta rritur efikasitetin për periudhën 2018-2022 janë:

- Fuqizimi i rolit koordinues i ASK-së në Sistemin Statistikor të Kosovës;
- Rritja e produktivitetit afatgjatë të sistemit 3-5% në bazë vjetore;
- Fuqizimi i procesit planifikues dhe zhvillimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore (krijimi i njësisve të reja, trajnimet e brendshme dhe racionalizimi i vendeve të punës);

Cilësia dhe levërdia e prodhimit

Sistemi Statistikor i Kosovës (SSK) tashmë është sistem i konsoliduar, pothuajse në shumicën e komponentëve të tij. Prandaj, meqenëse për periudhën e ardhshme synimi është për ta fuqizuar dhe avancuar edhe më shumë këtë sistem, është shumë e rëndësishme, që në këtë periudhë, të rritet edhe më shumë cilësia e të dhënave statistikore. SSK është cilësor dhe i dobishëm, vetëm nëse arrihet një ndërveprim i ngushtë dhe konstruktiv me përdoruesit. Prandaj, ky Program strategjik synon zgjerimin e gamës dhe cilësinë e prodhimit të statistikave, duke u bazuar kryesisht në një ndërveprim të tillë. Në këtë synim do të ndërtohet një Sistem për Menaxhimin e Cilësisë, pavarësisht se janë bërë disa aktivitete të rëndësishme në këtë drejtim. Po ashtu, synohet që të realizohet një ndërveprim sistematik me përdoruesit, në kuptimin e efektshmerisë dhe dobisë së statistikave zyrtare për politikë bërjen, për zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit, si dhe relevanca e tyre te organizatat ndërkombëtare. Prandaj, synohet të fuqizohet edhe më shumë bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Objektivat kryesore në këtë lëmi për periudhën 2018-2022 janë:

- Dokumentimi i metodave dhe përshkrimi i procesit në planifikimin vjetor;
- Finalizimi i menaxhimit të cilësisë në nivel institucional, sipas standardeve ndërkombëtare;
- Rritja e cilësisë së prodhimit përmes ndërveprimit me përdorues, duke përfshirë rregulloren e komunikimit dhe promovimin e prodhimeve statistikore;
- Unifikimi në zbatimin e modeleve statistikore si GSBPM (validimi, inputimi, etj.);
- Përmirësimi i besueshmërisë dhe shfrytëzimi i të dhënave statistikore;
- Zgjerimi i grupeve të përdoruesve për statistika të rëndësishme, si informata kthyese, me qëllim të përmirësimit të statistikave zyrtare;
- Rritja e numrit të prodhimeve statistikore në përputhshmëri me PSZ-në;
- Rritja e transparencës së statistikave;
- Pjesëmarrje në SDDS

Për t'i monitoruar përparimet, përmes identifikimit të treguesve të performancës, këto objektiva janë elaboruar më shumë në pjesën 2.3. Ndërkaq, synimet e PSZ-së janë cekur sipas prioriteteve në pjesën 4.

1.1 Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare

Sipas Ligjit për Statistikat Zyrtare, ASK-ja është bartësi kryesor i statistikave zyrtare në Sistemin Statistikor të Kosovës. Prandaj në bazë të përgjegjësisë që ka, ndërmerr nismat dhe bashkërendon të gjitha aktivitetet ndërinstitucionale, për ndërtimin e planeve afatgjata dhe afatshkurtra në kuadër të SSK. Sipas renditjes së proceseve planifikuese, në kuadër të synimeve të PSZ-së, bën pjesë edhe Plani Vjetor për Statistika Zyrtare (PVSZ) pasi që objektivat e planeve vjetore gjithmonë për bazë kanë objektivat e PSZ-së.

Objektivat e planeve vjetore

Objektivi specifik i PVSZ-së është përdorimi më i mirë i burimeve të ASK-së përmes rritjes së efikasitetit të vetë institucionit brenda kuadrit të burimeve ekzistuese. Plotësimi i këtij synimi do t'i mundësojë ASK-së që të:

- Ta rrisë numrin dhe ta përmirësojë cilësinë e prodhimeve statistikore me burimet aktuale njerëzore dhe buxhetore të saj;
- Ta rris nivelin e përputhshmërisë me standardet e BE-së;
- Ta rris mbështetjen për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve kombëtare për ASK-në;
- Të sigurojë fonde shtesë, stabile, nga donatorët bashkëpunues ndërkombëtarë;
- Të tërheq më shumë fonde përmes punës me partnerë të ndryshëm.

Banka Qendrore e Kosovës dhe Ministria e Financave prodhojnë statistika, si pjesë e aktivitetet të tyre të zakonshëm.

2 SISTEMI STATISTIKOR I KOSOVËS

2.1 Parimet e Planifikimit

2.1.1 Ligji mbi Statistikat Zyrtare

Parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane të vendosura në Ligjin për Statistikat Zyrtare në Republikën e Kosovës, janë udhërrëfim i qartë se në çfarë standarde duhet të bazohen prodhimet dhe publikimet e statistikave zyrtare.

Ligji vendos hapat e planifikimit afatgjatë dhe afatshkurtër të statistikave zyrtare. Programi i Statistikave Zyrtare (PSZ) përbën kornizën e prodhimit statistikor. Programi pesëvjeçar hartohet nga ASK-ja, duke marrë në konsideratë edhe rekomandimet e Këshillit Statistikor dhe në konsultim me përdoruesit dhe prodhuesit e statistikave zyrtare. PSZ është i orientuar nga Programi Statistikor i BE-së (Eurostatit). Programi përfshin hulumtimet statistikore, të nevojshme për sigurimin e të dhënave mbi gjendjen demografike, sociale, ekonomike, bujqësore e mjedisore dhe të tjera në Kosovë, duke u përqendruar në fenomene thelbësore për vendimmarrësit, si dhe duke respektuar të drejtën e qytetarëve për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ligji përshkruan edhe përmbajtjen e PSZ-së, kushtet e prodhimit, të mbledhjes së të dhënave, përpunimit dhe shpërndarjes së tyre. Po ashtu, Ligji shpjegon edhe detyrimet për t'i përdorur standardet ndërkombëtare dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, si dhe metodat për shkëmbimin e të dhënave.

Ligji për Statistikat Zyrtare u mundëson dhe i fuqizon agjencitë prodhuese për mbledhjen, grumbullimin, ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave burimore dhe harmonizimin e tyre, si dhe aplikimin e ndëshkimeve në rast të raportimit. Përgjegjësia institucionale për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen (desiminimin) e këtyre statistikave është sqaruar në mënyrë të qartë me këtë Ligj. Bazuar në zbatimin e përgjegjësive ligjore, shkëmbimi i të dhënave dhe koordinimi ndërmjet anëtarëve të Sistemit Statistikor është në nivel të kënaqshëm.

2.1.2 Procesi planifikues

ASK-ja në konsultim me prodhuesit statistikorë është përgjegjëse mbi procesin e planifikimit ndaj përdoruesve të statistikave dhe ndaj rekomandimeve nga Këshilli Statistikor.

Bazën e këtij Programi strategjik 2018-2022 e formojnë: prodhimi aktual, kërkesat e përdoruesve vendorë dhe ndërkombëtarë, kërkesat nga strategjitë e ndryshme rajonale dhe më gjerë, kërkesat ndaj procesit të integriteteve evropiane, si dhe kërkesat nga organizatat e tjera ndërkombëtare (OKB, FMN, BB, etj.). Një format planifikues përmes

planeve vjetore (bazuar në dëshmi) është zbatuar gjatë tërë ciklit të Programit të Statistikave Zyrtare 2013-2017. Kjo tregon se procesi planifikues është realizuar sipas standardeve ndërkombëtare, duke u bazuar në Kornizën e Vlerësimit të Performancës për funksionimin e brendshëm të ASK-së. Zbatimi i kësaj kornize ka mundësuar nxjerrjen e raporteve të rregullta mbi përparimet, zhvillimet dhe procesin e prodhimit.

Nevojat për ndryshim në planifikimin dhe në përmbajtjen e Programit pesëvjeçar kanë ardhur nga prodhuesit e statistikave zyrtare përmes kontakteve të tyre me përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm. Ndryshimet kanë të bëjnë me çështje të mbulimit dhe cilësisë së prodhimit, si: shpeshësia, saktësia, krahasueshmëria dhe aspektet e shpërndarjes.

Është hartuar një listë e këtyre nevojave me afatet e propozuara (sipas vitit në periudhën pesëvjeçare) për ndryshim, së bashku me tabelat e gjendjes aktuale. Këto përbëjnë një instrument që mund të përdoret për caktimin e prioriteteve. Prioritetet e prodhimit të të dhënave do të caktohen duke marrë në konsideratë nivelin e mjeteve buxhetore, kapacitetin e organizatës, si dhe potencialin njerëzor në dispozicion. Qasja e orientuar drejt procesit, e përdorur në PVSZ, do të përdoret po ashtu edhe në Programin pesëvjeçar. Që plani të jetë operativ i duhet një mekanizëm monitorues. Për këtë është ndërtuar Korniza e Vlerësimit të Performancës për programin e kaluar pesëvjeçar, por që do zbatohet dhe avancohet edhe gjatë periudhës së ardhshme pesëvjeçare, 2018-2022.

Si rrjedhojë e këtij procesi planifikues dhe në përputhje me Ligjin për Statistikat Zyrtare, Programi pesëvjeçar është përgatitur që t'i dorëzohet Qeverisë së Kosovës për miratim.

2.1.3 Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane

Sistemi Statistikor Evropian ka një Kod të Praktikës Statistike, që përbëhet prej 15 parimeve. Struktura e këtij kodi është e ndarë në tri pjesë përbërëse, si: mjedisi institucional, proceset statistikore të prodhimit dhe prodhimet statistikore. Parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane i nënshtrohen procesit të ndryshimit dhe plotësimit, varësisht prej zhvillimeve të përgjithshme në Sistemin Statistikor Evropian. Vlerësimi i Sistemit Statistikor kombëtar për një vend të caktuar, bëhet në bazë të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, duke u bazuar në secilin prej treguesve të secilit Parim.

Në plotësim-ndryshimin e Ligjit për Statistikat Zyrtare në Kosovë janë të gjitha parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane: Pavarësia profesionale, mandati për të mbledhur të dhëna, burimet e mjaftueshme, përkushtimi ndaj cilësisë, konfidencialiteti statistikor, paanshmëria dhe objektiviteti, metodologjia e duhur, procedurat e duhura statistikore, ngarkesa jo e tepruar mbi të anketuarit, kost-efektiviteti, relevanca, saktësia dhe besueshmëria, afatet kohore dhe përpikmëria, koherenca dhe krahasueshmëria, si dhe qasja dhe qartësia.

2.1.4 Rekomandimet nga “Peer Review” dhe Këshilli Statistikor

Bazuar në parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, Sistemi Statistikor Kombëtar i nënshtrohet një vlerësimi profesional nga Eurostati. Sistemi Statistikor i Kosovës, deri më tani, ka pasur dy vlerësime të Sistemit Statistikor, si: AGA 2012 dhe “Peer Review 2017”. Në raportin final të “Peer Review” janë dhënë rekomandimet që duhet të zbatohen në kuadër të Sistemit Statistikor të Kosovës. Gjithashtu, edhe Këshilli Statistikor i Kosovës (me mandat pesëvjeçar) i ka dhënë rekomandimet e veta për Sistemin Statistikor të Kosovës. Këto rekomandime do të jenë pjesë përbërëse e rëndësishme e këtij Programi pesëvjeçar.

2.2 Përshkrimi i sistemit

2.2.1 Përdoruesit

Përdoruesit kryesorë të statistikave zyrtare janë institucionet në nivel qendror dhe lokal, institucionet e tjera kombëtare, komuniteti i biznesit, institutet hulumtuese dhe akademike, mediat, shoqëria civile dhe publiku i gjerë, si dhe organizatat ndërkombëtare, si: OKB, BE, FMN, Banka Botërore, OECD, etj.

Të gjithë përdoruesit kryesorë në vend dhe më gjerë, janë listuar nga prodhuesit e produkteve statistikore gjatë procesit të planifikimit. Kontakte të caktuara janë kryer me përdoruesit, në mënyrë që të merren informacione, lidhur me mendimet e tyre për prodhimin aktual. Janë grumbulluar nevojat dhe janë marrë sugjerimet për përmirësime të statistikave, lidhur me mbulueshmërinë dhe cilësinë.

Udhëzimet ndërkombëtare për përmbajtjen në fusha të caktuara të statistikave zyrtare janë dhënë kryesisht nga: OKB, BE, FMN, Banka Botërore, OECD, etj. Këto institucione zhvillojnë dhe mirëmbajnë metoda, standarde dhe klasifikime, që duhet të përdoren dhe duhet të ndiqen edhe nga Sistemi Statistikor i Kosovës. Këto institucione prodhojnë dhe shpërndajnë, statistika ndërkombëtare, andaj edhe duhet të shihen si përdorues kryesorë të statistikave zyrtare të Kosovës. Kosova synon integrimet evropiane, prandaj standardet e aplikuar janë të bazuara në këto udhëzime ndërkombëtare.

2.2.2 Këshilli Statistikor

Këshilli Statistikor (KS) është pjesë shumë e rëndësishme e Sistemit Statistikor të Kosovës. Në mandatin e parë, gjatë periudhës 2013-2017, ky Këshill ka pasur 13 anëtarë, ndërsa me plotësim-ndryshimin e Ligjit për Statistikat Zyrtare parashihet që Këshilli t'i ketë 15 anëtarë. Funkionimi i Këshillit Statistikor bazohet në rregulloren e vet, që e miratojnë anëtarët e Këshillit. Përbërja e Këshillit Statistikor është e përcaktuar me Ligj dhe finalizohet me një vendim të veçantë nga Qeveria e Kosovës.

Rekomandimet e Këshillit Statistikor kanë karakter konsultativ, ndërsa raportet vjetore të KS dërgohen në Qeveri.

është përgjegjëse për të siguruar informacione për Bruto Produktin Vendor (BPV) në baza vjetore dhe tremujore, treguesit e tregut të punës, të popullsisë dhe të kushteve të jetesës, buxhetin e ekonomive familjare dhe gjendjen mbi ekonomitë bujqësore. Këto informata vihen në dispozicion të përdoruesve sipas kalendarit të publikimeve, në frekuencë të ndryshme: mujore, tremujore dhe vjetore. Në fund të çdo viti, ASK-ja publikon kalendarin e prodhimeve statistikore për vitin e ardhshëm.

Po ashtu, ASK-ja ka përgjegjësi ta krijojë, ta menaxhojë, ta mirëmbajë dhe ta freskojë:

- Regjistrin e popullsisë,
- Regjistrin e ekonomive familjare,
- Regjistrin e shtëpive dhe banesave,
- Regjistrin e ekonomive bujqësore,
- Regjistrin statistikor të bizneseve,
- Regjistrin e njësive hapësinore dhe
- Regjistra të tjerë, sipas planeve dhe vendimeve.

ASK-ja është përgjegjëse që metodologjitë statistikore, të përdorura në Kosovë, të jenë në përputhje me metodologjitë e përdorura në vendet e tjera në BE. Që të jetë në gjendje t'i zbatojë këto objektiva, ASK-ja në mënyrë të vazhdueshme përditëson procedurat në përdorimin e nomenklaturave, mbledhjen e të dhënave, përpunimin e të dhënave dhe shpërndarjen e tyre.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është subjekt juridik publik me kompetencë të plotë bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në Ligjin për BQK-në. BQK ka pavarësi dhe autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese si dhe është institucioni kyç, pjesëmarrës dhe rregullativ, në sistemin financiar të Kosovës. Objektivi parësor i BQK-së është (1) të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave. Objektiva të tjera të BQK-së janë (2) të kontribuojë në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore; (3) të mbështesë politikat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë; dhe (4) të veprimi në pajtim me parimin e ekonomisë së tregut të hapur me konkurrencë të lirë, duke favorizuar shpërndarjen efikase të resurseve.

BQK, sipas mandatit ligjor përpilon Statistikat Monetare e Financiare (SMF) dhe Statistikat e Sektorit të Jashtëm (SSJ) të ekonomisë së Kosovës. SMF mbulon kryesisht statistikën e sektorit financiar, siç janë të dhënat për bankën qendrore, bankat komerciale, kompanitë e sigurimeve, fondet e pensioneve institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit e tjerë financiar. Kurse, SSJ mbulon kryesisht statistikën e bilancit të pagesave, pozicionet e investimeve ndërkombëtare, statistikën e borxhit të jashtëm, rezervat ndërkombëtare dhe statistikën e investimeve direkte, remitencat, letra me vlerë jashtë vendi, etj.

BQK ka autoritetin për t'i siguruar të dhënat e nevojshme statistikore. Ky aspekt ligjor është i rregulluar me Ligjin për BQK-në dhe i plotësuar me dy rregullore përkatëse për grumbullimin e informatave statistikore. Rregulloret janë të miratuara nga Bordi i BQK-së, bazuar në Ligjin për BQK-në.

Përpilimi dhe publikimi i statistikave nga Departamenti i Statistikave (DS) i BQK-së bëhet në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe në praktikat më të mira të vendeve të tjera. DS bashkëpunon ngushtë me njësitë relevante të BQK-së dhe palët e tjera brenda dhe jashtë vendit për të përgatitur statistika të sakta e të besueshme, si dhe për ta avancuar më tej Sistemin Statistikor.

Ministria e Financave (MF) ka për mision të bëjë parashikime dhe analiza për ta mbështetur procesin e vendimmarrjes, lidhur me formulimin e politikave ekonomike. Një nga detyrat më të rëndësishme të MF-së është përgatitja e buxhetit të shtetit, menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore. Objektivi kryesor është përgatitja e analizave më të besueshme mbi zhvillimet aktuale ekonomik dhe dhënia e këshillave me kohë ndaj goditjeve të mundshme, me të cilat mund të përballet ekonomia e Kosovës. MF është e ngarkuar për të monitoruar, analizuar dhe për të bërë kërkime, lidhur me trendët makroekonomike dhe ngjarjet aktuale në Kosovë. Po ashtu, të përgatisë parashikime afatmesme për zhvillimin ekonomik nën skenarë të ndryshëm të politikës ekonomike. Gjithashtu, MF ofron raporte përmbledhëse mbi zhvillimet makroekonomike dhe politikave ekonomike, parashikimeve të variablave kryesore makroekonomike dhe sektoriale, të cilat do të shërbejnë si të dhëna për modelin makroekonomik dhe debate të politikave ekonomike. Ministria e Financave është përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e politikës fiskale të Qeverisë.

Ministria e Financave e informon publikun për përmirësimet e mundshme në planin e ardhshëm afatmesëm dhe për performancën financiare të Qeverisë. MF është duke e zgjeruar përdorimin e standardeve ndërkombëtare dhe teknologjive, për ta bërë më të lehtë dhe më të arritshëm në kohë informacionin mbi pagesat që ndodhin në vend gjatë një dite. Këto të dhëna janë paraqitur çdo muaj në seritë kohore, ku paraqiten të gjitha të hyrat dhe pagesat nga Buxheti i Kosovës. Këto të dhëna janë të publikuara në uebfaqen e Ministrisë së Financave.

Ofruesit e tjerë. Ekzistojnë edhe ofrues të tjerë të të dhënave, që përdoren për prodhimin e statistikave zyrtare në Kosovë. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është përgjegjëse për ta regjistruar numrin i shkollave, nxënësve dhe mësuesve në çdo nivel arsimor; Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik janë përgjegjës për regjistrimin e numrit të institucioneve shëndetësore, pacientëve, mjekëve dhe sëmundjeve. Ministria e Punës së Brendshme është përgjegjëse për të dhënat e emigracionit etj. Megjithatë, ofrues tjetër i statistikave zyrtare mund të jetë vetëm institucioni, i cili merr autorizimin nga ASK-ja për plotësimin e kritereve për prodhimin e statistikave zyrtare.

2.2.5 Burimet Financiare

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018-2020 (KASH 2018-2020) paraqet dokumentin kryesor për hartimin e Buxheti Vjetor për 2018. Në këtë dokument, në kuadër të fushave prioritare të Qeverisë, Sistemi Statistikor i Kosovës është i sistemuar në kuadër të fushës prioritare “*Qeverisja e mirë dhe sundimi i Ligjit*”. Në kuadër të PKZMSA prioriteti për statistikat zyrtare është vendosur tek pjesa “Zhvillimi i kapaciteteve të Sistemit Statistikor, në veçanti të disa statistikave sektoriale kyçe për politikëbërjen”. Andaj, burimet financiare për vitin 2018 dhe vitet e tjera në vijim, do të jenë në harmoni me objektivat, prioritetet dhe mundësitë buxhetore për kohën e Programit të Statistikave Zyrtare. Qeveria e Kosovës për vitin 2018 ka ndarë një buxhet prej 1 619 217.18 EUR, si dhe rritje të stafit nga 149 në 159 pozita.

Ndarjet buxhetore për të gjitha vitet në këtë Program do të bëhen në harmoni me mundësit dhe vendimet e Qeverisë së Kosovës, Ministrisë së Financave dhe Kuvendit të Kosovës.

Buxheti i vitit 2018 tregon se 69.6% e buxhetit përdoret për paga, 29.0 % për mallra dhe shërbime, si dhe më pak se 1.5% për shërbime komunale.

Për periudhën e përmendur në Programin 2018-2022 dhe të bazuar në KASH, planifikimi i buxhetit në euro për ASK-në është si në vijim:

Tabela 1b: Parashikimi i buxhetit të ASK-së për 2018-2022

Kategoritë	Vitet				
	2018	2019	2020	2021	2022
	<i>Përlllogaritur</i>	<i>Parashikuar</i>	<i>Parashikuar</i>	<i>Parashikuar</i>	<i>Parashikuar</i>
Paga dhe Mëditje	1,039,382	1,100,702	1,162,022	1,223,342	1,272,398
Mallrat dhe shërbimet	432,96	567,96	567,96	567,96	567,96
Shpenzimet kapitale		150	150	150	150
Komunali	21,875	21,875	21,875	21,875	21,875
Totali	1,494,217	1,840,537	1,901,857	1,963,177	2,012,233
Nr. i punëtorive	159	169	179	189	197

Kontributet dhe donatorët

Gjatë viteve të kaluara, ASK-ja ka pasur mbështetje të madhe nga një numër i konsiderueshëm i donatorëve, sidomos në dy regjistrimet: Regjistrimi i Popullsisë 2011 dhe Regjistrimi i Bujqësisë 2014. Në vitet e fundit, kontributet e donatorëve janë destinuar për zgjerimin e kapaciteteve njerëzore dhe grumbullimin e të dhënave të veçanta, inicimin e publikimit të prodhimeve të reja statistikore etj. Në kuadër të Programit IPA, ASK-ja vazhdon të marrë mbështetje për fuqizimin e statistikave zyrtare. Projekti aktual 2013-2017 ndërmjet ASK-së dhe Sida-s është në fazën përfundimtare. Në periudhën e ardhshme, ASK-ja do ta ketë mbështetjen nga Banka Botërore, lidhur me statistikën e ekonomisë së pa vërtuar (informale) dhe statistikën për të ardhurat dhe kushtet e jetesës (SILC). Projekti trevjeçar me BE-në, lidhur me mbështetjen e ASK-së në komponentet: statistikën macro-ekonomike, statistikën e biznesit, të energjisë dhe SILC, tregu i punës, në fushën e TI me theks të veçantë në modernizimin e proceseve prodhuese si dhe në fushën e koordinimit të sistemit statistikor të Kosovës.

Gjatë periudhës referuese të PSZ 2018-2022, nga donatorët pritet mbështetje buxhetore dhe profesionale edhe për realizimin e Projektit të Regjistrimit të Popullsisë 2021. Gjithashtu, mbështetje për ASK-në do të ketë edhe nga agjencitë e OKB-së të vendosura në Kosovë, siç janë: UNDP, UNICEF, UNFPA, etj., kurse FMN-ja planifikohet ta mbështes BQK-në dhe ASK-në.

Për prodhimin e disa statistikave të veçanta zyrtare, gjatë periudhës së kaluar, ASK-ja ka përdorur edhe burime të tjera financiare. Këto aktivitete, ASK-ja i ka realizuar duke u bazuar në nenin 33 të Ligjit për Statistika Zyrtare, përmes të cilit ASK-ja ka të drejtë të bëjë përpunime të veçanta statistikore, me buxhet të kërkuarit të statistikave zyrtare, qoftë ai institucion vendor ose ndërkombëtar. Kjo formë e të hyrave është rregulluar përmes Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 të aprovuar nga Qeveria e Kosovës.

Në ndërkohë, UA Nr. 08/2012, në bazë të rekomandimit të ZAP-së është në proces të ndryshimit, kështu që ASK-ja do të vazhdojë të prodhojë edhe në të ardhmen statistika të veçanta zyrtare.

Të hyrat nga shitja e të dhënave statistikore

Bazuar në praktikën botërore për shitjen e të dhënave të ndryshme statistikore, si dhe në kërkesat e shumta nga përdoruesit vendorë dhe ndërkombëtarë për blerjen e tyre, ASK-ja tashmë e ka vendosur këtë mundësi në plotësim-ndryshimin e Ligjit për Statistika Zyrtare. Rregullimi i procedurave për shitjen e të dhënave statistikore do të bëhet përmes akteve nënligjore të aprovuar nga Qeveria e Kosovës dhe do t'i zbatojnë institucionet për prodhime statistikore.

Të hyrat që krijohen nga realizimi i kësaj përgjegjësie do të shfrytëzohen për aktivitete shtesë për prodhimin e statistikave zyrtare, sipas legjislacionit në fuqi.

Përfitimet nga produktiviteti

Gjatë viteve 2018-2022, ASK-ja do ta avancojë në vazhdimësi KVP-në që do t'i mundësojë nivelit të mesëm dhe të lartë të menaxhimit në ASK të marrë vendime të duhura, lidhur me ndarjen e punës ndërmjet stafit.

Për ta lehtësuar shkëmbimin e informacionit në ASK, përveç avancimit të intranetit, sistemi SIPK do të avancohet në Sistem të Menaxhimit të Performancës (SMP). Gjithashtu, ASK-ja do t'i zbatojë edhe modulet e sistemit të ashtuquajtur "Generic Statistical Business Process Model" (GSBPM).

Me rastin e finalizimit të Sistemit të Menaxhimit të Performancës (SMP), ASK-ja do të ketë mundësi që të gjenerojë raporte nga më të ndryshme, me qëllim të rritjes së produktivitetit.

Burimet njerëzore

Burimet njerëzore janë shumë të rëndësishme për ASK-në, jo vetëm sa i përket numrave, por edhe në pikëpamje të shkathtësive. Aktualisht (dhjetor 2017), në ASK janë duke punuar 145 persona nga gjithsejtë 149 pozita. Në aspektin e gjinisë, 51.7% janë femra dhe 48.3% janë meshkuj. Kurse, moshë mesatare është rreth 48 vjet. Struktura kualifikuese: 85.3% e stafit ka një diplomë universitare dhe 14.7% me arsimim të mesëm. Në zyrën qendrore të ASK-së janë të punësuar 69.2%, kurse në zyrat rajonale janë 30.8% të të punësuarve, derisa 10% janë të punësuar nga komunitetet pakicë.

Gjatë periudhës së kaluar pesëvjeçare është bërë rritja dhe fuqizimi i kapaciteteve administrative profesionale të ASK-së. Kjo ka mundësuar në rritje të konsiderueshme të raporteve statistikore, nga 79 sa ishin në vitin 2012, në 113 raporte statistikore në vitin 2017.

Bazuar në objektivat dhe prioritetet e PSZ 2018-2022 dhe në rekomandimet e "Peer Review 2017", ASK-ja do ta zbatojë racionalizimin e vendeve të punës. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, prioritet do të jetë ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale.

Rritja e burimeve njerëzore për 10 pozita, e planifikuar për vitin 2018, do të ketë efekt pozitiv të rritja e prodhimit statistikor në fushën e statistikave ekonomike, sociale dhe në njësinë e TI-së. Kurse, për vitet 2019-2022 janë planifikuar edhe 38 pozita të reja.

Infrastruktura dhe Teknologjia Informativë

ASK-ja ka në zbatim disa sisteme nga "e-Qeverisja", siç janë: sistemi i vijueshmërisë në punë, sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore, sistemi i menaxhimit të pagesave, sistemi i evidentimit dhe kontrollit të mjeteve financiare, sistemi i arkivimit elektronik të dokumenteve administrative, sistemi i furnizimit me material për zyre, etj. ASK-ja, tashmë disponon me qindra baza të shënimeve, regjistra elektronikë, duke përfshirë

edhe kopjet e tyre (back up), të vendosur në serverë të ndryshëm dhe të menaxhuar me aplikacione dhe sisteme të avancuara të TI-së. Tashmë, ASK-ja ka në përdorim platformën PXWeb, të ashtuquajtur ASKData.

Avancimi i këtyre kapaciteteve infrastrukturore të TI-së për periudhën e ardhshme pesëvjeçare është prioritet i ASK-së. Do të zbatohen platformat e së ardhmes, të ashtuquajtura Big Data, Open Data, interoperabiliteti, etj.

2.2.6 Ofruesit

Sipas Ligjit për Statistikat Zyrtare, ASK-ja ka të drejtë të kërkojë të dhëna nga njësi fizike dhe institucione të ndryshme të Republikës së Kosovës (njësi raportuese), përfshirë agjenci publike dhe ministri të linjës. BQK përveç bazës ligjore nga LSZ, mbledhjen e të dhënave e ka të rregulluar edhe me Ligjin për BQK-në dhe dy rregullore përkatëse për grumbullimin e informatave statistikore.

ASK-ja i shfrytëzon burimet primare dhe sekondare të të dhënave. Burimet primare janë: ekonomitë familjare, ndërmarrjet, feramat, etj. Të dhënat e grumbulluara trajtohen si konfidenciale dhe nuk përdoren për asnjë arsye tjetër përveç për qëllime statistikore.

Ministritë dhe agjencitë e tjera publike cilësohen si burime sekondare të të dhënave për ASK-në. Bazuar në Ligjin për Statistikat Zyrtare, si dhe në Marrëveshjet e Mirëkuptimit (MeM) ndërmjet ASK-së dhe këtyre institucioneve, ofrohen të dhëna sipas kërkesave të ASK-së. Konfidencialiteti i të dhënave të ofruara respektohet në mënyrë rigorozë nga ana e ASK-së, sipas ligjeve përkatëse në fuqi. Për këtë qëllim, ASK-ja i siguron, i informon dhe komunikon, në mënyrë të vazhdueshme me ofruesit e të dhënave administrative.

ASK-ja ka arritur një bashkëpunim shumë të mirë me një numër të konsiderueshëm të institucioneve publike, si p.sh: Doganat, Policinë, ATK-në, ARC-në, MBPZhR-në, MMPH-në, AVUK-un, ARBK-në, MASHT-në, BQK-në, MF-në, MPMS-në, MZHE-në, kadastrat, MD-në, Organet Gjqësore, Ministrinë e Shëndetësisë, MKRS dhe institucione të tjera që japin kontribut në ofrimin e të dhënave. ASK-ja, gjithashtu ka vendosur raporte me shoqatat e biznesit, Oden Ekonomike të Kosovës, hulumtuesit dhe OJQ-të. Bashkëpunimi me palët e lartpërmendura do të rritet në periudhat e ardhshme, duke marrë për bazë ngritjen dhe përmirësimin e performancës edhe nga ana e tyre në aspektin e konsolidimit të bazës së shënimeve dhe avancimit të sistemeve teknike. ASK-ja edhe në periudhat e ardhshme do ta rrisë komunikimin edhe me ofrues të tjerë të të dhënave administrative, më qëllim të ndjekjes së ndryshimeve, për t'i përdorur në funksion të rritjes së vazhdueshme të cilësisë së të dhënave statistikore.

Krijimi i regjistrave elektronikë administrativë, nga ana e ofruesve të të dhënave, do të jetë ndihmë e madhe për ASK-në, në mënyrë që të dhënat të merren shpejt, saktë dhe sigurt.

ASK-ja do ta vazhdojë bashkëpunimin me partnerët e saj në aspektin e rritjes së outputeve, si dhe avancimin e metodave për mbledhjen e të dhënave.

2.3 Korniza e Vlerësimit të Performancës

2.3.1 Hyrje

Korniza e Vlerësimit të Performancës (KVP) shërben për monitorimin e zbatimit të objektivave të PSZ-së. Përmes kësaj kornize, vazhdimisht monitorohen prodhimi dhe proceset e prodhimit statistikor. KVP-ja ka filluar së zbatuari në vitet 2013/2014, si fazë testuese, ndërsa nga viti 2015 kjo kornizë është zbatuar në tërësi. Me këtë kornizë mundësohet matja e performancës, në aspektin e numrit dhe cilësisë së prodhimeve statistikore, kohës prodhuese, normës së publikimeve në kohë, etj. KVP-ja siguron një platformë shumë të avancuar për raportim, monitorim, planifikim dhe një menaxhim të orientuar në procese.

2.3.2 Përshkrimi i Sistemit të KVP-së

Sistemi i KVP-së punon si një skemë raportimi nga njësitë të udhëheqësit e departamenteve. Administrimi dhe mbikëqyrja e sistemit kryhet nga Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim në ASK.

Në KVP, çdo proces pune ose produkt i paracaktuar është një "dosje". Një person është i caktuar si përgjegjës i një dosjeje (zakonisht kreu i aktivitetit). Personi përgjegjës i një procesi ose produkti, në bazë të inputeve ditore, bën raportimin mujor. Personat përgjegjës për produktet përkatëse e plotësojnë një format të kompjuterizuar të raportimit, që është një imazh pasqyruar i përshkrimit të procesit të PVSZ, duke i detajuar burimet e përdorura në faza të ndryshme të prodhimit (normalisht 7 faza). Pastaj, dosja përditësohet në një dosje-master në intranet. Dosja Master, i përditëson automatikisht përmbledhjet e fushave (departamenteve) statistikore dhe i evidenton shmangiet nga plani.

Me qëllim të vendimmarrjes së bazuar në dëshmi, në procesin e ardhshëm planifikues, drejtuesit e departamenteve e shqyrtojnë përditësimin e Master Dosjes për fushën e tyre dhe i raportojnë ngjarjet kryesore, duke e identifikuar një përmbledhje (të gjetur), për Departamentin e Planifikimit, i cili pastaj raporton te Kryeshefi i ASK-së.

Treguesit kyç në procesin e prodhimit dhe rezultatet, raportohen nga drejtuesit e departamentit në shkurt të çdo viti. Në përgjithësi, KVP-ja përbëhet nga treguesit, afati kohor dhe përgjegjësitë. Kjo është ilustruar në Figurën 1:

Figura 1: Korniza e Vlerësimit të Performancës

(A) Treguesit

<p>Raportimi i aktivitetit në procesin e punës</p> <p>Përmbajtja: kalendari i procesit, shfrytëzimi i bugjetit, burimet.</p>	<p>Raportimi i prodhimit në nivel departamenti</p> <p>Përmbajtja: sasi të prodhuese, shpenzimi i bugjetit</p>	<p>Raportimi i rezultateve në nivel departamenti</p> <p>Përmbajtja: Cilësia dhe efikasiteti i proceseve të prodhimit. Cilësia e produktit dhe shërbimeve të përdoruesve</p>	<p>Vlerësimi përgjithshëm i performancës</p> <p>Përmbajtja: Planifikimi i bazuar në shënime për fazën tjetër (PVSZ).</p>
---	--	--	---

(B) Afatet kohore

<p>Raportimi i aktivitetit të procesit të punës</p> <p>Në fund të secilit muaj.</p>	<p>Raportimi i prodhimit në nivel departament</p> <p>Në fund të shkurtit të secilit vit.</p>	<p>Raportimi i rezultatit në nivel departamenti</p> <p>Në fund të shkurtit të secilit vit.</p>	<p>Vlerësimi i përgjithshëm i performancës</p> <p>Fundi i marsit të secilit vit. Kërkesa për buxhet në maj të secilit vit.</p>
--	---	---	---

(C) Përgjegjësitë

<p>Individët (zakonisht udheheqësit e njësisve) Përgjegjës për çdo proces pune.</p>	<p>Drejtorët e Departamentit përgjegjës për raportimin e prodhimit.</p>	<p>Drejtorët e Departamentit përgjegjës për raportimin e rezultatit.</p>	<p>Departamenti i Planifikimit të Përgjithshëm në ASK dhe drejtori.</p>
---	---	--	---

Përgjegjësia për sistemin e KVP-së, në përgjithësi qëndron në Departamentin e Politikave, Planifikimit, Koordinimit dhe Komunikimit, që është në krye të monitorimit për respektimin e afateve kohore. Ky departamentet e monitoron edhe skemën e raportimeve dhe i ofron Takimit të rregullt të Drejtorëve dhe Kryeshefit vlerësime të vazhdueshme mujore dhe vjetore mbi përformancën.

2.3.3 Treguesit e Performancës

Monitorimi i përformancës edhe në të ardhmen do të përfshijë 8 tregues kryesorë, që kapin aspektet e prodhimit, efikasitetit organizativ dhe zhvillimin e produktit (cilësinë dhe shtrirjen). Ndërsa, aspektet e kënaqshmërisë së përdoruesve, që aktualisht nuk kanë një bazë monitorimi, do të hartohen përmes zhvillimit të anketave me përdorues. Shih Figurën 2.

Figura 2. 8 indikatorët kryesorë të Kornizë së Vlerësimit të Performancës

Nr.	Rezultati dales	Burimi	Metoda e mbledhjes	Zyrtari përgjegjës	Plani kohorë
1	Nr. i produkteve të publikuara	Përpunimi i dosjes së plotë	Raportimi njësi & dept.	Drejtori i Dept	Nga (data)
2	Nr. i variablave	Përshkrimi i produktit	Raportimi njësi & dept.	Drejtori i Dept	Nga (data)
3	Nr. i indikatorëve kryesorë	Përshkrimi i produktit	Raportimi njësi & dept.	Drejtori i Dept	Nga (data)
Nr. Pritjet dalëse	Burimi	Metoda e mbledhjes	Zyrtari përgjegjës	Plani kohorë	
4	Dit-njerez ne input/produkt	Raporti procesit	Raportimi njësit & dept.	Drejtori njësisë	Nga (data)
5	Koha kalendarike nga fundi i periudhësreferuese te publikimi/produkti	Raporti procesit	Raportimi njësit & dept.	Drejtori njësisë	Nga (data)
6	Norma e publikimit në kohë	Raporti procesit	Raportimi njësit & dept.	Drejtori njësisë	Nga (data)
7	Seritë kohorë të botuara për indikatorët kryesorë	Përshkrimi produktit	Raportimi njësit & dept.	Drejtori njësisë	Nga (data)
8	Vlersimet e gabimeve në mostra	Përshkrimi produktit	Raportimi njësit & dept.	Drejtori njësisë	Nga (data)

Treguesit janë zgjedhur për t'i monitoruar të gjitha hallkat e zinxhirit të procesit. Zinxhiri nuk përfaqëson marrëdhënien absolute, por një pritshmëri më të gjerë që përcjell këtë logjikë:

1. Një proces i planifikuar mirë sjell me vete rritjen e produktit (indikatorët 1-3) përmes një shpërndarje të përmirësuar të burimeve dhe rritjes së shkallës së efikasitetit të prodhimit (indikatorët 4-6);
2. Prioritetizimi i veprimeve do të kontribuojë në efikasitetin e prodhimit dhe cilësisë, duke përfshirë procesin/dosjet e dokumentacionit, metodologjinë e zhvillimit, forcimin e TI-së dhe shërbimet publikuese;
3. Një orientim kryesor për zhvillimin e produktit do të jetë krijimi i një dialogu sistematik me përdoruesit dhe kryerja e një ankete të rregullt me përdorues;
4. Efikasiteti dhe përdorimi më i mirë i dialogut, ofrojnë një ambient të favorshëm për zhvillimin e produktit, që duhet ta manifestojë veten përmes publikimeve, bazuar në mostra më të mëdha e më të mira, që pasqyrojnë trende të dhënash më të mira e të krahasueshme dhe ndarje të të dhënave të publikuara për nivelet rajonale dhe komunale (indikatorët 7-8);
5. Përgjithësisht, këto zhvillime duhet të kontribuojnë për një kënaqshmëri më të lartë të përdoruesve dhe besim te prodhimi statistikor.

Figura 3: Zinxhiri i tërësisë së treguesve KVP

Rezultati	Dalja e hershme dhe e mesme	Dalja e hershme dhe e mesme	Dalja afatgjate
<i>Ndryshimi sasior në prodhim</i>	<i>Ndryshimet në efikasitetin institucional</i>	<i>Ndryshimet në prezantimin dhe cilësinë e produktit</i>	<i>Kënaqshmëria e përdoruesit vlerësimi I produktit</i>
1. Nr i produkteve të publikuara	4. Dit-njerëz në input/produkt	7. Seritë kohore të publikuara	<i>Të dizajnohen me zhvillimin e një Pyetësi sistematik të përdoruesve</i>
2. Nr i variablave/ produkteve	5. Koha kalendarike nga fundi i periudhës referuese te publikimi i produktit	8. Vlerësimi i gabimeve të mostrave	
3. Nr indikatorëve/prod. kryesore	6. Norma e publikimeve në kohë		

KVP-ja do të bëjë vlerësime analitike në:

- **Planifikimin e zhvillimit të procesit.** Zhvillimin e kornizës së planifikimit, funksionimin e raportimit dhe vetë kornizën e planifikimit.
- **Përafërimin me BE-në dhe vlerësimin e cilësisë sipas produkteve.** Treguesit kryesorë që gjenden te parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane dhe tek standardet e tjera ndërkombëtare për statistika zyrtare, do të përdoren për vlerësimin e përafrimit të Sistemit Statistikor të Kosovës me Sistemin Statistikor Evropian. (Shih Aneksin 4)
- **Zhvillimin e dialogut me përdorues.** Procesi i institucionalizimit të dialogut me përdorues do të vlerësohet së bashku me zhvillimin e instrumenteve të tilla, si: Pyetësi i përdoruesve dhe Anketat e kënaqshmërisë së përdoruesve.
- **Kënaqshmërinë e përdoruesve.** Bazohet në pyetjet lidhur me cilësinë, afatet kohore, krahasueshmërinë, etj.
- **Statusin e ASK-së.** ASK-ja tashmë është institucion konsoliduar për prodhimin e statistikave zyrtare në Kosovë. Bazuar në vlerësimet e ekspertëve ndërkombëtarë në Raportin “Peer Review 2017”, SSK në përgjithësi është në pajtueshmëri me Kodin e Praktikës Evropiane për Statistika.

2.3.4 Gjendja bazë dhe pikësynimet

Me qëllim të monitorimit dhe matjes së performancës, gjatë tërë ciklit të zbatimit të Programit strategjik të Statistikave Zyrtare, është e nevojshme të caktohet statusi bazë në fillim të periudhës dhe pikësynimeve në fund të periudhës së Programit strategjik. Kjo është e mundur përmes strukturës që ka Korniza e Vlerësimit të Performancës në kuadër të Sistemit Statistikor të Kosovës, e cila ofron informacione bazë në çdo kohë.

Për treguesit e zgjedhur nga 1-8, mbledhja sistematike (raportimet nga njësitë) deri në shkurt të vitit 2018 përbëjnë informacionin themelor për gjendjen bazë me shifrat e vitit 2017. Ndërsa, nga viti 2018-2022 do të monitorohet i tërë numri i treguesve të performancës dhe

Produktiviteti

Treguesit 4-6 shënojnë aspektet e efikasitetit prodhues. Gjatë periudhës 2018-2022, treguesit 4 dhe 5 do të jenë treguesit kryesorë të ndryshimeve në produktivitet dhe në efikasitet të prodhimit. Ky tregues (4) mat kohën e shpenzuar në prodhimin e një produkti statistikor. Në vitin 2017 janë shpenzuar mesatarisht 127 ditë pune për 57 prodhime, respektivisht 89 ditë pune për 113 raporte statistikore.

Cilësisë dhe shtrirja e prodhimit

Treguesit 1-3 përcaktojnë numrin e publikimeve, treguesve dhe variablave statistikore. Ndërsa, treguesit 7-8 tregojnë arritjen në aspektin e cilësisë për prodhimet statistikore, me qëllim të përmirësimit dhe përgjigjeve ndaj kërkesave të veçanta të përdoruesve për statistika më të mira. Treguesit 1-3 dhe 7-8 informojnë për shtrirjen e prodhimit.

Gjatë periudhës pesëvjeçare, prodhimi i treguesve statistikorë do të monitorohet dhe vlerësohet sipas listës së treguesve kryesorë, të publikuar nga Eurostati. Informacion ky, që merret nga treguesi 3 i KVP-së. Kjo do ta mundësojë pasqyrimin e nivelit të përfshirjes së treguesve statistikorë të Kosovës në nivel rajonal dhe evropian.

3.1 Tabelat e prodhimit

Statistikat Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare

ID	Depart- menti	Prodhimet dhe shërbimet statistikore	Frekuenca e publikimit	Partnerët e jashtëm	Ndar- ja e ngark e-sës	Koha e harxhua r për prodhim 2017	Koha e harxhuar për prodhim 2022 (të prishme)	Ndrys- himi i kohës së prodh- imit %	Input et e Buri- meve njerëz- ore 2017	Inputet e Burimeve njerëzore 2022 (të prishme)	Ndrysh- imet në inputet e BNJ %
BP	DSELLK	BPV e shpenzimeve dhe e prodhimit	Vjetore	IPA (Projekt Kombëtar 2018-2021), Banka Botërore, IPA MB	2.8%	300	237	-21%	118	95	-19%
BP	DSELLK	BPV e shpenzimeve dhe e prodhimit (TM1-TM4)	Tremujore	IPA (Projekt Kombëtar 2018-2021), Banka Botërore, IPA MB	28.2%	365	308	-16%	1177	970	-18%
BP	DSELLK	Llogaritë Qeveritare	Vjetore	IPA (Projekt Kombëtar 2018-2021), FMN, IPA MB	1.3%	159	133	-16%	53	49	-8%
BP	DSELLK	Llogaritë Qeveritare (TM1-TM4)	Tremujore	IPA (Projekt Kombëtar 2018-2021), FMN, IPA MB	2.3%	406	290	-29%	94	88	-6%
BP	DSELLK	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit	Vjetore	Asnjë	1.1%	157	152	-3%	48	46	-4%
BP	DSELLK	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit	Mujore	Asnjë	6.8%	139	139	0%	286	281	-2%
BP	DSELLK	IÇIMP (TM1-TM4) 150 ndërmarrje	Tremujore	Asnjë	5.8%	272	238	-13%	242	222	-8%
BP	DSELLK	IÇP (TM1-TM4, 2018) 150 ndërmarrje	Tremujore	Asnjë	5.8%	278	243	-13%	242	222	-8%
BP	DSELLK	Indeksi i Kostos së Ndërtimit IKN (TM1-TM4) 150 ndërmarrje	Tremujore	Asnjë	5.8%	290	257	-11%	242	222	-8%
BP	DSELLK	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	Vjetore	Asnjë	0.5%	159	156	-2%	19	17	-11%
BP	DSELLK	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	Mujore	Asnjë	5.9%	300	287	-4%	245	235	-4%
BP	DSELLK	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve	Vjetore	IPA (Projekt Kombëtar 2018-2021)	6.6%	339	330	-3%	276	252	-9%

BP	DSELLK	Anketa e Përdorimit të Teknologjisë së Informatike dhe Komunikimit në Biznese (ICT)	Vjetore	Asnjë		0	270			330	
	DSELLK	TOTAL					6.632			5.399	

Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

ID	Departamenti	Prodhimet dhe shërbimet statistikore	Frekuenca e publikimit	Partnere-rë të jashtëm	Ndarja e ngarkesës	Koha e harxhuar për prodhimin 2017	Koha e harxh-uar për prodhimin 2022 (të pritshme)	Ndryshimi i kohës së prodhimit %	Inputet e Burimeve njerëzore 2018	Inputet e Burimeve njerëzore 2022 (të pritshme)	Ndryshimet në inputet e BNJ %
BP	DSBM	Regjistrimi i Bujqësisë	Nuk ka	Asnjë	2%	-	-	-	40	36	-12%
BP		Anketa e Ekonomive Bujqësore (7000 EB)	Vjetore	Asnjë	26%	286	180	-37%	540	475	-12%
BP	DSBM	Statistikat agromonetare/çmimet e prodhimeve bujqësore	Tremujore dhe Vjetore	Asnjë	8%	136	136	0%	172	151	-12%
BP		Statistikat agromonetare/çmimet e inputeve bujqësore	Tremujore dhe Vjetore	Asnjë	7%	160	160	0%	152	133	-12%
BP	DSBM	Statistikat agromonetare/Llogaritë Ekonomike për Bujqësi	Vjetore	Asnjë	9%	330	240	-27%	193	170	-12%
BP	DSBM	Anketa e Mbeturinave Industriale AMI (800 ndërmarrje industriale)	Çdo dy vjet	Asnjë	8%	358	290	-18%	170	150	-12%
BP	DSBM	Anketa e Mbeturinave Komunale AMK (53 kompani publike e private)	Vjetore	Asnjë	5%	335	210	-37%	105	95	-12%
BP	DSBM	Anketa e Mbeturinave të Trajtuara AMT (150 ndërmarrje industriale)	Vjetore	Asnjë	6%	302	250	-17%	90	82	-8,8%
BP	DSBM	Statistikat e ajrit, në veçanti emitimi i gazrave serrë (GHGE)	Çdo dy vjet	Asnjë	4%	274	270	-1,5%	80	70	-13%
BP	DSBM	Statistikat e ujit	Çdo dy vjet	Asnjë	4%	91	90	-1,0%	88	77	-12%

Publikimet e DMTI-së

ID	Departamenti	Prodhimet dhe shërbimet statistikore	Frekue-ncat e publikimit	Partnerët e jashtëm	Ndarja e ngarkesës	Koha e harxhuar për prodhimin 2017	Koha e harxhuar për prodhimin 2022 (të pritshme)	Ndryshimi i kohës së prodhimit %	Inputet e Burimeve njerëzore 2017	Inputet e Burimeve njerëzore 2022 (të pritshme)	Ndryshimet në inputet e BNJ %
BP	DMTI	Shërbime ndaj departamenteve	Nuk ka	Asnjë	67%	-	-	-	428	343	-20%
BP	DMTI	Buletini Tremujor	Tremujore	Asnjë	6%	129	103	-20%	36	29	-20%
BP	DMTI	Kosova në Shifra	Vjetore	Asnjë	4%	272	220	-19%	26	21	-19%
BP	DMTI	Katalogu i Publikimeve	Vjetore	Asnjë	4%	90	72	-20%	24	19	-20%
BP	DMTI	Kalendari i Publikimeve/ Fletëpalosje/ Poster	Vjetore	Asnjë	3%			-	19	15	-21%
	DMTI	Vjetari Statistikor	Vjetor	Asnjë	16%	182	157	-14%	104	90	-14%
	DMTI	TOTAL			100%				637	517	-19%

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

ID	Departamenti	Prodhimet dhe shërbimet statistikore	Frekuenca e publikimit	Partnerët e jashtëm	Ndarja e ngarkesës	Koha e harxhuar për prodhimin 2017	Koha e harxhuar për prodhimin 2022 (të pritshme)	Ndryshimi i kohës së prodhimit %	Inputet e Burimeve njerëzore 2017	Inputet e Burimeve njerëzore 2022 (të pritshme)	Ndryshimet në inputet e BNJ %
CPOS	BQK	Statistikat e Sektorit Financiar	Mujore	Asnje	8%	20	15	-25%	30	23	-25%
CPOS	BQK	Statistikat bankare	Mujore	Asnje	3%	10	8	-25%	10	8	-25%
CPOS	BQK	Statistikat e normave te interesit	Mujore	Asnje	3%	10	8	-25%	10	8	-25%
CPOS	BQK	Statistikat e institucioneve jobankare	Mujore	Asnje	8%	30	23	-25%	30	23	-25%
CPOS	BQK	Statistikat e bilancit te pagaseave	Mujore	Asnje	38%	75	56	-25%	135	101	-25%
CPOS	BQK	Statistikat e pozicionit të investimeve ndërkombëtare	Tremujore	Asnje	21%	75	56	-25%	75	56	-25%

OBJEKTIVAT DHE PRIORITETET

4.1 Kërkesat e zhvillimit

4.1.1 Historiku

Zyra e Statistikave në Kosovë ka funksionuar që nga viti 1948. Në vitin 1999, ky institucion rifilloi së funksionuar si Ent-institucion i pavarur dhe profesional, nën Rregulloren e UNMIK-ut deri në vitin 2011. Në fund të vitit 2011, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Statistikat Zyrtare, ish-Enti u shndërrua në Agjenci të Statistikave të Kosovës, ku edhe u përcaktuan shumë çartë përgjegjësitë ligjore të prodhuesve të statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës.

BQK është pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, e kjo e fundit e Autoritetit Bankar dhe i Pagesave të Kosovës - themeluar në nëntor të vitit 1999. Pas vitit 1999, stafi i bankës qendrore ka rritur shumë kapacitetet dhe aftësitë për të përpiluar statistikave me standarde ndërkombëtare. Sot, BQK-ja është një institucion stabil dhe i aftë për të kryer të gjitha detyrat që kërkohen.

Sipas Ligjit për Statistikat Zyrtare, Programin e Statistikave Zyrtare për periudhën pesëvjeçare dhe planet vjetore për zbatimin e Programit, ASK-ja është e obliguar t'i dërgojë në Qeverinë e Kosovës për miratim.

4.1.2 Rekomandimet nga vlerësimet aktuale

Për Sistemin Statistikor të Kosovës, në periudhën e kaluar, janë bërë dy vlerësime ndërkombëtare: AGA 2012 dhe Peer Review 2017. Këto vlerësime janë të nivelit të lartë profesional, në kuptimin e auditimit të Sistemit Statistikor të Kosovës në përgjithësi dhe ASK-së në veçanti.

Rekomandimet e AGA 2012 janë realizuar përmes një Plani të veprimit që nga viti 2012 e deri më tash. Ndërsa, 14 rekomandimet që kanë dalë nga raporti "Peer Review 2017" do të realizohen në kuadër të objektivave dhe prioriteteve gjatë periudhës së ardhshme pesëvjeçare.

Rekomandimet që dalin nga raporti "[Peer Review 2017](#)" janë të përmbledhura në: Kornizën e konsolidimit institucional, rritjen e burimeve dhe zbatimin e kost-efektivitetit, zhvillimin e menaxhimit të cilësisë dhe metodologjisë, si dhe fuqizimin e marrëdhënieve me përdorues.

Në kuadër të Kornizës së Konsolidimit Institucional janë dhënë rekomandimet, që në rishikimin e Ligjit të Statistikave të Kosovës të fuqizohet pavarësia profesionale dhe institucionale e ASK-së dhe roli koordinues i ASK-së, përfshirja dhe konsultimi i ASK-së në ndryshimin eventual të regjistrave administrativë në institucione të ndryshme të

Sfidë përcaktuese konsiderohet sigurimi i buxhetit të mjaftueshëm për projekte dhe anketa me rëndësi. Rreziqet më të përgjithshme, që janë të lidhura ngushtë me forcimin e sistemit, që shfaqen në mungesën e burimeve njerëzore dhe profesionale janë:

Te burimet njerëzore - Sistemi administrativ aktual ka një shkallë të lartë ngurtësie përsa i përket emërimeve nëpër poste të larta administrative. Procedurat janë shumë strikte në nivel të administratës publike për rritjen e numrit të stafit në ASK.

Te burimet profesionale - Duke pasur parasysh mungesën e burimeve të saj, ASK-ja duhet ta zhvillojë edhe më tej menaxhimin e cilësisë për ta rritur kost-efektivitetin e saj, duke ndjekur parimin e përmirësimit të vazhdueshëm në identifikimin e dobësive dhe kërkimin e proceseve, rezultateve dhe shërbimeve përmirësuese. Synim mbetet zhvillimi i kapaciteteve profesionale me qëllim të aplikimit të një modeli të integruar të prodhimit. Zhvillimet e reja në metodologji, mbledhje të të dhënave etj., do ta ndihmojnë ASK-në ta rrisë cilësinë e rezultateve të saj.

ASK-ja ballafaqohet edhe me sfida të tjera, si: Avancimi i mëtejshëm i kapaciteteve profesionale; barrierat në qasje të disa burimeve administrative; të dhënat e pakompletuara administrative në disa institucione, p.sh. baza të shënimeve, regjistra administrativë etj.; mungesa e hapësirës fizike dhe kushteve normale për punë, etj.

4.2 Objektivat

4.2.1 Objektivat institucionale

Pas konsolidimit institucional, ASK-ja në periudhën e ardhshme ka për objektiva zhvillimin dhe avancimin e proceseve prodhuese me qëllim të realizimit të vizionit dhe misionit të saj, të përcaktuar me ligj. Procesi i menaxhimit në të gjitha nivelet do të vazhdojë të mbështetet përmes Sistemit të Menaxhimit të Performancës, në mënyrë që planifikimi të jetë i bazuar në rezultate, kërkesa dhe nevoja të përdoruesve.

Objektiv në të ardhmen do të vazhdojë të jetë rritja e efikasitetit organizativ të ASK-së. Gjatë periudhës së ardhshme do të krijohet Departamenti i Llogarive Kombëtare dhe të fuqizohen departamentet e statistikave prodhuese dhe ato mbështetëse me staf shtesë. Komponenta e ngritjes profesionale do të jetë pjesë e këtij objekti.

Aspekti organizativ dhe funksional në të gjitha njësitë e tjera të ASK-së do të jetë në vazhdimësi në fokus të politikave zhvillimore të ASK-së, me qëllim të rritjes së produktivitetit dhe rritjes në vazhdimësi të cilësisë së prodhimeve statistikore. Në një periudhë afatgjatë, ASK-ja parashikon rritje të produktivitetit 4-5% në vit. Në perspektivën afatshkurtër, 1-2 vjeçare, dobishmëria do të jetë më e lartë krahasuar me periudhën 5 vjeçare në përgjithësi.

Objektiv tjetër institucional do të jetë rritja e koordinimit ndërinstucional me institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Prioritet në aspektin koordinativ do të jenë institucionet që prodhojnë statistikën zyrtare dhe institucionet që janë burime të rëndësishme të të dhënave administrative.

Objektiv i ASK-së do të jetë vendosja e kriterëve për prodhime të statistikave zyrtare. Ky objektiv është shumë i rëndësishëm, jo vetëm për faktin se është pjesë e rekomandimeve të institucioneve me renome ndërkombëtare, por për faktin se Sistemit Statistikor të Kosovës mund t'i shtohen edhe prodhues të tjerë të statistikave zyrtare me rastin e zbatimit të këtyre kriterëve.

Objektiv për këtë periudhë është fuqizimi e marrëdhënieve me përdoruesit, duke krijuar instrumente për kuptim më të mirë dhe marrja e sugjerimeve të tyre rreth prodhimeve statistikore. Imazhi për statistika të qëndrueshme dhe të besueshme do të jetë angazhim i vazhdueshëm i ASK-së, në mënyrë që përdoruesi të jetë i kënaqur. Për realizimin e këtij objekti do të ndërtohen edhe mekanizma të tjerë mbështetës, në mënyrë që institucionet, siç janë: akademia e shkencave, universitetet dhe institucionet e tjera hulumtuese, të kenë qasje dhe shfrytëzim sa më të lehtë të të dhënave, deri në nivel të mikrodatave për aq sa lejohet me ligj.

Objektiv tjetër do të jetë zbatimi i parimit të konfidencialitetit. ASK-ja do ta forcojë kulturën e bashkëpunimit për konfidencialitetin dhe të rris kapacitetet profesionale të stafit të saj për të zbatuar konfidencialitetin statistikor. Për më tepër, ASK-ja do të garantojë ofruesit kryesorë të të dhënave për zbatimin e konfidencialitetit statistikor. Do të vendosen disa masa institucionale për të mbrojtur të dhënat konfidenciale nga pikëpamja teknike dhe ligjore. Kjo do të arrihet përmes zhvillimit të udhëzuesve, dokumentimit të proceseve ekzistuese të sigurimit të konfidencialitetit statistikor, zhvillimit të një infrastrukture të përshtatshme, për qasje të sigurt nga ana e përdoruesve të jashtëm në të dhënat statistikore, dhe dokumentimi i përgjegjësive për konfidencialitet.

Një nga objektivat më të rëndësishme në ASK do të jetë komunikimi efektiv. Prandaj, sistemi METADATA në ASK do të synojë të aplikojë një metodë të thjeshtë, të çartë dhe koncize që të mundësoj një kuptim të përbashkët nga të gjithë personat që punojnë në ASK.

Objektiv tjetër është Standardizimi statistikor i të dhënave dhe metadatave. Kjo do të arrihet përmes zhvillimit dhe përdorimit të sistemit të menaxhimit të të dhënave statistikore të centralizuara nga metadata në prodhim; Mbledhja e standardizuar e të dhënave, përfshirja, validimi dhe mjedisi i grumbullimit për domenet e statistikave; Përmirësimi i efektivitetit të ASK-së; Arkitektura e sistemit të TI-së, që bazohet në procese të përbashkëta dhe të dokumentuara.

ASK-ja edhe gjatë periudhës së ardhshme do t'i jepe përparësi cilësisë, në të gjitha proceset e prodhimit statistikor. Një nga proceset më të rëndësishme të prodhimit statistikor është mbledhja e të dhënave. Prandaj, do të përdoren sisteme të avancuara

për mbledhjen e të dhënave nga terreni, siç janë metodat CAPI (Intervistë Personale me Ndhmën e Kompjuterit) dhe CAWI (Intervistë Personale përmes Ueb Aplikacionit). Proces tjetër në sigurimin e cilësisë në prodhimin statistikor është shkurtimi i afateve kohore për publikimin e të dhënave statistikore. Aplikimi i modeleve statistikore GSBPM do ta rrisë kost-efektivitetin e proceseve statistikore dhe do ta ngrisë cilësinë e prodhimeve statistikore.

Objektiva për Sistemin e Integruar Statistikor (SIS) të Teknologjisë Informative do të vazhdojë të jetë objektiv edhe përgjatë periudhës së ardhshme pesëvjeçare. Për arritjen e SIS-it do të ndihmojë realizimi i projekteve që dalin nga zbatimi i interoperabiliteti, sidomos nga përdorimi i sistemeve informative administrative dhe të dhënat nga regjistrat elektronikë, që menaxhohen nga insitucionet e tjera të vendit.

Banka Qendrore e Kosovës

Në mënyrë që të realizojë objektivat e veta, BQK prodhon një gamë të gjerë të statistikave që ofrojnë një pasqyrë statistikore të shëndoshë të zhvillimit të Kosovës në aspektin e sektorit financiar dhe të jashtëm, dhe shkallën e lartë të krahasueshmërisë ndërkombëtare. Progres i rëndësishëm është bërë gjatë viteve të fundit në rritjen e mbulueshmërisë, zgjerim të gamës së statistikave, përmirësim të frekuencës dhe afatit të publikimeve, si dhe ë përmirësim të cilësisë së statistikave që prodhon BQK. Megjithatë, ka disa objektiva për të kompletuar më mirë portofolin e statistikave zyrtare në përgjithësi. Publikimi i produkteve të reja statistikore, rritja e mbulimit, shkurtimi i mëtejme i afateve të publikimeve, konvergjenca e plotë me manualët e reja ndërkombëtare, si dhe konvergjenca me legjislacionin statistikor të BE-së -janë qëllimet që duhet të arrihen në pesë vitet e ardhshme. Vlerësimi i pavarur i zhvillimeve ekonomike është një nga aktivitetet më të rëndësishme për të arritur një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe afatgjatë në Republikën e Kosovës. Prandaj, statistikave që janë në domenin e BQK-së do të avancohen edhe më tutje. Fushat me prioritete strategjike të identifikuar nga BQK për pesë vitet e ardhshme janë paraqitur më poshtë, në kuadër të matricës së objektivave sipas fushave statistikore (shih pjesën statistikave financiare dhe të jashtëm).

Ministria e Financave

Ministria e Financave informon publikun për përmirësimet e mundshme në planin e ardhshëm afatmesëm dhe se si është bërë performanca financiare e Qeverisë. Ministria e Financave është duke zgjeruar përdorimin e standardeve ndërkombëtare dhe teknologjive duke e bërë në këtë mënyrë më të lehtë dhe në kohë të arritshëm informacionin mbi pagesat që ndodhin në vend gjatë një dite. Këto të dhëna janë paraqitur çdo tre muaj në një format që është i mundur të arrihet në faqen e internetit të Ministrisë. Këto informacione përdoren për të prodhuar vlerësime tremujore makroekonomike dhe publikime gjysmë - vjetore mbi situatën ekonomike në vend.

Qëllimet strategjike kryesore

- Shkurtimi i kohës së informacioneve për Qeverinë e Kosovës për situatën makro-ekonomike dhe financiare;
- Ruajtja e stabilitetit makro-ekonomik të vendit përmes hartimit të politikave të qëndrueshme ekonomike;
- Sigurimi i regjistrimit të faturave me kohë dhe në përputhje me kodet COIFOG;
- Zhvillimi i mëtejshëm në analiza ekonomike;
- Sigurimi i funksionalitetit të vazhdueshëm i sistemit elektronik të llogarive dhe procedurat e tij;
- Sigurimi i zbatimit të legjislacionit tatimor dhe doganor në Republikën e Kosovës;
- Mbikëqyrja e institucioneve të administratës publike për zbatimin e rregullave dhe procedurave në fuqi, përkritazi me shpenzimet publike, duke përfshirë prokurimin publik pa paragjykim ndaj kompetencave të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm;
- Ofrimi i politikave të qëndrueshme fiskale;
- Hyrje në borxhe publike sipas legjislacionit në fuqi;
- Bashkërendimi dhe koordinimi i aktiviteteve me institucionet ndërkombëtare financiare.

4.2.3 Matricat e objektivave strategjike

4.2.3 Matricat e objektivave sipas fushave statistikore

Matricat e objektivave sipas fushave statistikore janë nxjerrë nga formatet e Qeverisë së Kosovës për dokumentet e karakterit strategjik. Objektivat e fushave janë radhitur sipas pritjeve të kornizës kohore. Në pjesën 4.3. janë dhënë edhe direktivat strategjike.

Statistikat Ekonomike

Veprimi	Institucioni përgjegjës	Institucioni Partner	Treguesit vlerësues	Statusi i gjendjes bazë	Periudha kohore	Fondet
Objektivi i fushës së statistikave ekonomike: promovimi i një kuptimi më të mirë të ekonomisë kosovare, duke siguruar të dhëna të sakta, relevante dhe në kohë, të llogarive kombëtare, çmimeve, statistikave të biznesit, investimeve, tregtisë së jashtme, si një objektivi dhe me kosto-efektive në drejtim të kërkesave të BE-së						
Nën /Objektivi 1.1 Llogaritë Kombëtare						
1.1.1 Aplikimi i ndryshimeve nga ESA95 në ESA 2010	Njësia: LLK	Njësi tjetër në ASK, MF, BQK	Hulumtimi dhe Zhvillimi (R&D), Llogaritë Sektoriale, FISIM dhe të tjera	Në fazën fillestare planifikuese	2018-2022	Buxheti i Kosovës
1.1.2 Përpilimi i tabelave ofruese-përdoruese (SUT) dhe Tabelat Input dhe Output (IOT),	Njësia: LLK	Njësi tjetër në ASK, MF, BQK	Përgatitja e tabelave për vitet 2015-2018 (Produkt i ri)	Në fazën fillestare eksperimentale 2013 dhe 2014	2018-2022	Buxheti i Kosovës

1.1.3 Ngritja e efikasitetit me shkurtrimin e kohës së publikimit të BPV vjetore dhe tremujore	Njësia: LLK	Njësi tjetër në ASK, MF, BQK	Reduktimi i kohës prodhuese për 21% për vjetore dhe 16% tremujore	BPV Vjetorje T+10 muaj, BPV Tremujore t+90 ditë	2018-2022	Buxheti i Kosovës
1.1.4 Matja e Ekonomisë joformale	Njësia: LLK	Njësi tjetër të ASK, MF (ATK dhe Dogana), MPB, dhe agjencitë publike	Shkalla e pjesëmarrjes së ekonomisë joformale në BPV (Produkt i ri)	Në fazën fillestare planifikuese	2018-2022	Buxheti i Kosovës dhe Banka Botërore
Nën /Objektivi: 1.2 Çmimet						
1.2.1 Përmirësimi i cilësisë përmes monitorimit më të mirë të grumbullimit të të dhënave nga terreni	Njësia: Çmimet	Departamenti për Regjistrime dhe Anketime	Planifikohet të rritet numri i vendburimeve dhe numri i artikujve dhe shërbimeve, sipas E-COICOP-it. Për IHÇK. Rritja e mostrës te: Indeksi i Çmimeve të Importit (IÇIMP) Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP) dhe Indeksi i Kostos së Ndërtimit (IKN)	IHÇK (6000 çmime/ 1016 vendburime), IÇIMP (570çmime/132 vendburime), IÇP 600 çmime/180 vendburime) dhe IKN (341 çmime/68 vendburime)	2018-2022	Buxheti i Kosovës
1.2.2 Rritja e efikasitetit më futjen e aplikacionit të ri të TI-së dhe me përmirësimin e mbledhjes së të dhënave	Njësia: Çmimet	Departamenti për Regjistrime dhe Anketime, si dhe Njësia e TI	Reduktimi i kohës prodhuese për 13% (përfshirë IHÇK 3%)	IHÇK vjetore (t+157ditë) IHÇK mujore (t+12 ditë) IÇIMP (t+68 ditë), IÇP (t+70 ditë) IKN (t+73 ditë)	2018 -2022	Buxheti i Kosovës
Nën /Objektivi: 1.3. Statistikat e Bizneseve						
1.3.1 Përmirësimi i cilësisë me rritjen e monitorimit të grumbullimit të të dhënave nga terreni për të gjitha anketat e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve (ASN), PRODCOM, Statistikat Afatshkurtra (STASH) të hotelerisë, tregtisë me pakicë, industrisë, energjisë, transportit, ndërtimit etj.	Njësia: Statistikat e Biznesit	Departamenti për Regjistrime dhe Anketime, MPB, MZHE	Rritja e numrit të tabelave dhe dërgimi i tyre në Eurostat, Publikimi i Indeksit të prodhimit industrial etj.	Sipas Pocket Book	2018 -2022	
1.3.2 Rritja e efikasitetit me futjen e aplikacionit të ri të TI-së dhe me përmirësimin e mbledhjes së të dhënave	Njësia: Statistikat e Biznesit	Departamenti për Regjistrime dhe Anketime dhe Njësia e TI	Reduktimi i kohës prodhuese prej 10 deri 13% (përfshirë të Repertorit, statistikave e	ASN (t+339 ditë), Industrisë (t+81 ditë) Tregtisë me pakicë (t+82 ditë), Repertori (t+31 ditë),	2018 -2022	

			transportit dhe ASN me nga 3%)	Transportit (t+30 ditë), Hotelierisë (t+68 ditë), Bilancit të Energjisë tremujore (t+48 ditë), Bilancit të Energjisë vjetore (t+186 ditë) dhe PRODCOM (t+347 ditë)		
1.3.3 Organizimi i anketës së re për investime	Njësia: Statistikat e Biznesit	Grumbulluesi i të dhënave, Departamenti për Regjistrime dhe Anketime	Përgatitja e pyetësorit, mostrës. Mbledhja e të dhënave, përpunimi dhe publikimi i të dhënave	Në fazën fillestare planifikuese	2018 -2022	
1.3.4. Organizimi i anketës së re për përdorimin e teknologjisë informative dhe komunikimit në biznese (ICT)	Njësia e statistikave të Biznesit	Grumbulluesi i të dhënave, Departamenti për Regjistrime dhe Anketime	Përgatitja e pyetësorit, mostrës. Mbledhja e të dhënave, përpunimi dhe publikimi i të dhënave	Në fazën fillestare planifikuese	2018 -2022	
Nën /Objektivi: 1.4. Regjistri i bizneseve						
1.4.1 Azhurnimi i Regjistrimit Statistikor të Bizneseve sipas përparësisë të problemeve cilësore	Njësia: Regjistri Statistikor i Bizneseve	ARBK, ATK dhe Njësitë e tjera në ASK	Përgatitja në kohë dhe me cilësi e: mostrave për anketat e ndërmarrjeve, të dhënat për llogaritë kombëtare, plotësimi i raportit (sipas SMIS).	E vazhdueshme (e përhershme)	2018 -2022	
Nën /Objektivi: 1.5. Tregtia e Jashtme						
1.5.1 Rritja e efikasitetit me aplikimin e pajisjes së re të TI-së (Sistemi i Integruar i Shpërndarjes) për shpërndarjen e të dhënave.	Njësia: Tregtia e Jashtme	Dogana, BQK, MF	Reduktimi i kohës së prodhimit për 3%	T+25 ditë	2018 -2022	

Statistikat Sociale

Vepri	Institucioni përgjegjës	Institucioni Partner	Treguesit vlerësues	Statusi i gjendjes bazë	Periudha kohore	Fondet
Objektivi i fushës së Statistikave Sociale: përmirësimi i cilësisë së të dhënave në harmoni me metodologjitë e Eurostatit, shkurtimi i afateve kohore të publikimeve, rritja e variablave të publikuara, zbatimi i Klasifikimeve Standarde Ndërkombëtare, zhvillimi i ad hoc moduleve dhe anketave të reja, transmetimi i më shumë të dhënave në Eurostat etj.						
Nën/Objektivi 1.1. Statistikat e Tregut të Punës						
1.1.1 Rritja e numrit të treguesve të rinj në AFP (zhvillimi i ad-hoc moduleve)	Njësia: Tregu i Punës	ASK dhe Zyrat Rajonale	Zhvillimi i ad hoc moduleve të AFP-së dhe reduktimi i kohës së prodhimit (Ende nuk është zhvilluar ndonjë ad-hoc modul i AFP-së. Nga viti 2018, AFP-së	2021	BKK

			kalimi nga publikimet tremujore në mujore)	do t'i shtohet çdo vit nga një ad-hoc modul		
1.1.2 Publikimi i të dhënave për nivelin e pagave në Kosovë në sektorin publik dhe privat, shtimi i treguesve të rinj	Njësia: Tregu i Punës	ASK, ATK, MAP	Shkurtimi i afatit të publikimit nga vjetore në tremujore	Për herë të parë janë publikuar të dhënat për vitet 2012-2016	2019	
Nën/Objektivi: 1.2 Statistikat e Standardit Jetësor						
1.2.1 Zhvillimi i Anketës mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (anketë e rregullt vjetore)	Njësia: Standardi Jetësor	ASK, MPMS	Produkt i ri	Janë zhvilluar këto aktivitete: përgatitja e pyetësorit, udhëzuesit, planifikimi i aktiviteteve në vitet 2017 dhe 2018 rreth zbatimit të anketës etj.	2019	Fondet e siguruar nga BB për vitin 2018 100,000\$
1.2.2 Zhvillimi i Anketës mbi Përdorimin e Teknologjisë Informativë (TIK) përmes metodës CAPI	Njësia: Standardi Jetësor	ASK dhe Zyrat Rajonale	Zhvillimi i anketës përmes metodës CAPI	Për herë të parë Anketa TIK është zhvilluar në vitin 2017 dhe tutje do të vazhdojë si anketë e rregullt	2019	
1.2.3 Zhvillimi i Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare çdo 4 vjet (ABEF)	Njësia: Standardi Jetësor	ASK dhe Zyrat Rajonale	Zhvillimi i ABEF çdo 4 vjet	Zhvillimi i ABEF 2017 në terren përfundon më 31 dhjetor 2017, ndërsa tutje do të zhvillohet çdo 4 vjet	2021	
Nën/Objektivi: 1.3 Statistikat e tjera sociale						
1.3.1 Krijimi i qasjes së ASK-së në sistemin SMIA dhe SMIAL	Njësia: Statistikave e tjera sociale	MASHT	Reduktimi i kohës së prodhimit	Të dhënat e arsimit publikohen në bashkëpunim me MASHT, mirëpo ende nuk kemi qasje në sistemin SMIA	2019	
1.3.2 Implementimi i ISCED 2011	Njësia: Statistikave e tjera sociale	MASHT, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, Agjencia Kosovare e Akreditimit	Kalimi nga ISCED97 në ISCED 2011	Është përgatitur draft harta për kalimin nga ISCED97 në ISCED 2011	2019	
1.3.4 Përmirësimi i cilësisë së të dhënave të mirëqenies sociale dhe shkurtimi i kohës së publikimit	Njësia: Statistikave e tjera sociale	MPMS	Harmonizimi i metodologjisë me Eurostat	Është duke u bërë identifikimi i skemave të reja të mirëqenies sociale	2022	
1.3.6 Përmirësimi i cilësisë së të		MKRS dhe Drejtoritë Komunale të Kulturës dhe Sportit	Publikimi i të dhënave të	Janë zhvilluar takime me	2020	

dhënave të kulturës, si dhe publikimi i të dhënave të sportit	Njësia: Statistikave e tjera sociale		sportit pas shkëputjes 3 vjeçare	MKRS-n, por nuk ka pasur progres deri më tani		
Nën/Objektivi: 1.4 Statistikat e Jurisprudencës						
1.4.1 Përmirësimi i cilësisë së të dhënave të jurisprudencës për personat e mitur dhe madhorë	Njësia: Statistikat e Jurisprudencës	Gjykatat Themelore, MD, KGJ	Reduktimi i kohës së prodhimit	Është bërë identifikimi i mangësive kryesore të të dhënave statistikore për krimin dhe drejtësinë penale, që kërkohen nga Eurostatit dhe UNDOC-ja	2019	
1.4.2 Zbatimi i Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Krimeve (KSNK)	Njësia: Statistikat e Jurisprudencës	Gjykatat Themelore, MD, KGJ	Raportimi i të dhënave në Eurostat sipas KSNK	Është duke u përkthyer në gjuhën shqipe Klasifikimi Ndërkombëtar i Krimeve	2019	
Nën/Objektivi: 1.5 Statistikat e Popullsisë						
1.5.1 Regjistrimi i Popullsisë, Eknomive Familjare dhe Banesave 2021	Njësia: Statistikat e Popullsisë	Qeveria e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, organizatat ndërkombëtare	Regjistrim sipas standardit botëror në çdo 10 vite	Regjistrimi i popullsisë 2011 dhe freskimi i Regjistrimit nga ky Regjistrim	2020-2022	
1.5.1 Digjitalizimi i Statistikave të Lindjeve	Njësia: Statistikat e Popullsisë	Agjencia e Regjistrimit Civil	Reduktimi i kohës së prodhimit dhe ngritja e cilësisë	Janë zhvilluar takime, por pa progres	2022	
1.5.2 Digjitalizimi i Statistikave të Vdekjeve	Njësia: Statistikat e Popullsisë	Agjencia e Regjistrimit Civil	Reduktimi i kohës së prodhimit dhe ngritja e cilësisë	Janë zhvilluar takime, por pa progres	2022	
1.5.3 Digjitalizimi i Statistikave të Kurorëzimeve	Njësia: Statistikat e Popullsisë	Agjencia e Regjistrimit Civil	Reduktimi i kohës së prodhimit dhe ngritja e cilësisë	Janë zhvilluar takime, por pa progres	2022	
1.5.4 Përmirësimi plotësimi me të dhëna statistikore, bazuar në pyetjet e pyetësorëve statistikorë të shkurorëzimeve nga njësitë raportuese (Gjykatat)	Njësia: Statistikat e Popullsisë	Gjykatat Themelore	Ngritja e cilësisë së të dhënave	Janë zhvilluar takime, por pa progres	2022	
1.5.5 Kodifikimi i diagnozave që kanë shkaktuar vdekjet nga ana e personelit mjeksor	Njësia: Statistikat e Popullsisë	Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik të Kosovës	Vazhdimi i përpunimit të statistikave të vdekjeve, sipas shkaqeve të vdekjeve në Kosovë dhe publikimi i tyre	IKSHPK nuk ka proceduar me kodifikimin	2018	

1.5.6 Rritja e treguesve socio-ekonomikë për analizimin e situatës gjinore në Kosovë	Njësia: Statistikat e Popullsisë	Institucionet qeveritare dhe joqeveritare	Ngritja e cilësisë së të dhënave, raportimi në Eurostat dhe Institutin European për Barazi Gjinore	Në proces	2018	
1.5.7 Rritja e treguesve kryesorë siç janë gjinia dhe mosha të vlerësimi i numrit të banorëve në Kosovë	Njësia: Statistikat e Popullsisë	Institucionet lokale dhe qendrore (raportimet e lëvizjeve të popullsisë)	Ngritja e cilësisë së të dhënave, raportimi në Eurostat	Është arritur progres dhe raporti do të jetë i gatshëm në vitin 2018	2018	
Nën/Objektivat e tjera nëse do të sigurohet buxhet nga BK ose donatorët						
Veprimi	Institucioni përgjegjës	Institucioni Partner	Treguesit vlerësues	Statusi i gjendjes bazë	Periodha kohore	Fondet
1.6.1 Zhvillimi i Anketës mbi Koston e Punës	Njësia: Tregu i Punës	ASK me Zyrat Rajonale, MPMS, Bizneset/Ndërmarrjet, Oda Ekonomike, Aleanca Kosovare e Bizneseve	Produkt i ri	Ende nuk ka filluar ndonjë aktivitet	2020	Projekti i BE-së
1.6.2 Zhvillimi i Anketës së Shëndetësisë	Njësia: Statistikat e tjera sociale	MSH, IKSHP	Produkt i ri	Ende nuk ka filluar ndonjë aktivitet	2019	?
1.6.3 Zhvillimi i Anketës mbi Arsimimin e të Rriturve	Njësia: Statistikat e tjera sociale	MASHT	Produkt i ri	Ende nuk ka filluar ndonjë aktivitet	2021	?
1.6.4 Zhvillimi i Anketës së Grupimeve të Treguesve të shumëfishitë (MICS)	Njësia: Statistikat e Popullsisë	MSH, IKSHP, MPMS, MASHT etj.	Kjo anketë për herë të parë është zhvilluar në vitin 2013	Në diskutim për fonde nga UNICEF dhe donatorët e tjerë	2018	?

Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Veprimi	Institucioni përgjegjës	Institucioni Partner	Treguesit vlerësues	Statusi i gjendjes bazë 2017	Periodha kohore	Fondet
